



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.598/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hajriz Hoti kryesues, Violeta Husaj Rugova, dhe Bujar Muzaqi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Subjektit Politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me seli në Prishtinë, për shkak të parregullsive gjatë numërimit të votave në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN) në Pejë, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë 21.02.2025, merr këtë,

V E N D I M

Pranohet e bazuar ankesa e parashtruar nga Subjekti Politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, Anr.598/2025, e datës 20.02.2025, e paraqitur kundër, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, për shkak të parregullsive gjatë numërimit të votave në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN) në Pejë, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të datës 09.02.2025, ashtu që urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), respektivisht Qendra Komunale e Numërimit në Pejë, që fletëvotimin në vendvotimin-kutia e votimit Nr.1706/05, të vlerësohet si i vlefshëm dhe i njëjti të rinumërohet dhe të përfshihet në rezultatin zgjedhor.

A r s y e t i m

Me datë 20.02.2025, PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga Subjekti Politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, në të cilën pretendon se me datën 19.02.2025, Qendra e Lëvizjes VETVENDOSJE! Kanë vërejtur se fletëvotimi nga vendvotimi Nr.1706/05, në Sallën e Sporteve " Karagaçi" në Pejë, komisionerët përkatës, kryesuar nga Shaban Halitaj, gjatë numërimit kanë shpallur të pavlefshëm fletëvotimin, edhe përkundër reagimit të vëzhguesve se fletëvotimi ka qenë në përputhje me nenin 16 të Rregullores Zgjedhore nr.12/2024 Votimi, Numërimi në Vendvotim dhe Menaxhim i Vendvotimit. Po ashtu ankuesi pretendon se në fletëvotim vërehet qartë qëllimi i votuesit se për cilin subjekt ka votuar, vetëm për faktin se në fletëvotim është vendosur shenja Tik për Subjektin Politik LVV, dhe se jashtë katrorit është vërejtur një vije e lehtë dhe se e njëjta nuk ka qenë e vendosur në asnjërin katror (shenjë) të ndonjë subjekti tjetër politik, andaj kërkojnë që fletëvotimi në fjalë të shpallet i vlefshëm. Provë kanë bashkangjitur fletëvotimin.

Në përgjigje në ankesë KQZ ka theksuar se për të pasur një pasqyrë më të qartë, lidhur me rastin konkret, KQZ, pas pranimit të kërkesës së PZAP, menjëherë ka kontaktuar me KKZ e Komunës së Pejës, duke pranuar përgjigjet dhe sqarimet si në vijim, duke dërguar; *Deklaratën e Kryesuesit të ekipit të numërimit për rastin konkret, i cili shpjegon ecurinë e procesit të verifikimit dhe numërimit të këtij fletëvotimi. Librin e votimit dhe përshkrimin e shënimeve për mbarëvajtjen e procesit të numërimit në VV në QKN, edhe për rastin konkret. Fletëvotimin që është objekt anekse në rastin konkret. Formularin e Rezultateve për VV konkret.* KQZ, ju njofton se i gjithë materiali zgjedhor duk përfshirë edhe kamerat e sigurisë, momentalisht gjendet në QKN të komunave përkatëse, mirëpo pas përfundimit të gjithë procesit të punës së QKN i njëjti material zgjedhor dorëzohet nga QKN në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve-QNR, dhe të njëjtat mund të verifikohen dhe hetohen nga PZAP dhe organet drejtësisë.

Paneli, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoi pretendimet ankimore, përgjigjen në ankesë vëren se ankesa është e bazuar.

Paneli vlerësoi se pretendimet e parashtruara në ankesë nga subjekti politik LVV me të cilën pretendon se për shkak të parregullsive gjatë numërimit të votave në Sallën e Sporteve "Karagaçi" në Pejë, gjatë numërimit fletëvotimi është shpallur i pavlefshëm nga komisionerët përkatës, për faktin se në fletëvotimin në fjalë është vendosur shenja Tik për subjektin politik LVV, e cila vërtetohet edhe nga fletëvotimi i dorëzuar si provë, dhe se jashtë katrorit vërehet një vije e lehtë e cila nuk është vendosur në asnjë katror (shenje) të ndonjë subjekti tjetër politik, paneli e vlerësoi se këto pretendime janë të qëndrueshme.

Bazuar në të lartcekurat, paneli duke u mbështetur në nenin 16 paragrafi 2 të Rregullores Zgjedhore Nr.12/2024, Votimi, Numërimi në Vendvotim dhe Menaxhim i Vendvotimit, vlerëson se votat konsiderohen të vlefshme në rastet si në vijim: "16.2. Vota është e vlefshme, kur votohet vetëm një subjekt politik dhe kuptohet qartë qëllimi i votuesit: 2.1. në zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës, vota konsiderohet e vlefshme nëse votuesi ka votuar për një (1) subjekt politik", Kurse nënparagrafi 2.2.2, i nenit 16 përcakton se "në zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës, vota konsiderohet e pavlefshme, në rastet kur: 2.2.2.1. Kur votohet më shumë se një subjekt politik; 2.2.2. kur nuk votohet asnjë subjekt politik; 2.2.3. kur votohen vetëm kandidatët dhe jo subjekti politik; 2.2.4. kur qëllimi i votuesit nuk është i qartë, sipas procedurave të votimit dhe numërimit në vendvotim." Prandaj në rastin konkret sipas vlerësimit të panelit fletëvotimi i cili është shpallur i pavlefshëm nuk hyjnë në kategorinë fletëvotimeve të pavlefshme siç është përcaktuar me nenin 16 paragrafi 2.2.2 të Rregullores së sipërcituar, për faktin se tiku është bërë brenda katrorit ku figuron numri 118, përkatësisht emërtimit i subjektit politik, Lëvizja Vetëvendosje, dhe se shenja e bërë jashtë katrorit në mes numrit 119 dhe 120, nuk e bënë fletëvotimin e pavlefshëm, e rrjedhimisht nga kjo sipas vlerësimit të panelit qëllimi i votuesit është i qartë dhe i vlefshëm.

Nga të gjitha këto arsye e duke u bazuar në dispozitat e nenit 117 paragrafi 4, lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me nenin 13 paragrafi 10 nën paragrafi 10.1 të Rregullores së PZAP-së Nr.01/2024, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

Anr.598/2025, datë 21.02.2025



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.